

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me kryetarin e trupit gjykues-gjyqtarin Sahit Krasniqi, dhe me sek juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.D. nga Ferizaj, për shkak të vepres penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/I.nr.41/16 të datës 19 shtator 2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 25.10.2016, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës prokurorit të shtetit Shukri Jashari, të akuzuarit I.D., të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri **I.D.**, nga Ferizaj, rr.”.....” data e lindjes....në Ferizaj, nga I ati I., e ëma S., e vajzërisë A., shqiptar, shtetas I R.Kosovës, ka të kryer shkollen fillore, I pa punë, I gjendjes së varfër ekonomike, ka qenë në arrest shtëpiak nga data 28 prill 2016 deri me datën 29 maj 2016.

### ESHTË FAJTOR

**Sepse :** me datën 28 prill 2016, rreth orës 20:40, në rr.”Bajram dhe Gursel Sylejamni”, në Ferizaj ka mbajtur pa autorizim me qëllim shitje substance të dyshuar narkotike, në atë mënyrë që derisa I pandehuri së bashku me dy persona të panjohur ishte duke qëndruar në park, aty kishte shkuar policia civile të cilet edhe janë prezentuar, I pandehuri nxjerr nga xhepi 7 qese me substance të dyshuar narkotike të llojit marihuana, të mbështjellura me qese të najlonit në peshë të përgjithshme 2.3 gram, I hedh në tokë dhe nuk ndalet në urdhërat e policies, vrapon në drejtim të një rrugice, me të dale në rrugën “Rexhep Bislimi” arrestohet nga policia dhe I sekuestrohet përkohësisht substance narkotike,

- Me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-se.

Në bazë të dispozitiës së sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, dhe 76 ,të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së , të pandehurin e ,

## G J Y K O N

I caktohet denimi me burgim në kohëzgjatje prej **1/një/ viti** ,i cili denim nuk do të ekzekutohet në qoftese i akuzuari në periudhen kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryern veper tjeter penale, dhe

**Dënim me gjobë** në lartësi prej **600/gjatëqind/euro** të cilin gjobë I akuzuari është I obliguar që ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formen e prer.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë të akuzuarit I llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt. 28 prill 2016 deri me dt. 29 maj 2016.

Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund te ekzekutohet ne format tjera te parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do ti shndërrohet ne dënim burgu, ashtu qe për çdo 20 euro të pandehurit do ti llogaritet një ditë burgu.

Konform nenit 273 par.5 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca e llojit mariuhan me peshë 2.3 gram.

Obligohet I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 (tridhjetë) € në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfauqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP.I.nr.41/16 të datës 19 shtator 2016 ka ngarkuar të akuzuarin I.D. nga Ferizaj, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK – së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25.10.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Shukri Jashari mbetet në tërsi pranë aktakuzes dhe I propozon gjykatës që të pandehurin të shpalle fajtores dhe të i shqipton një dënim të paraparë me ligj.

I akuzuari I.D. me rastin e deklaramit të pranimit apo mos pranimit të fajësisë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat i ngarkon aktakuza, në të gjitha pikat e saj dhe i propozon gjykatës që të i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
- pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt. 28.04.2016, raporti i ekspertizës me numër AKF/2016-1525/2016-1276 i dt. 21.07.2016 dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës dhe se
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit I.D.m manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale blerja, posedimi,

shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethana **veçanërisht lehtësuese** mori faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë, ndërsa si rrethana lehtësuese mori parasysh faktet se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike, është moshës së re, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, dhe mbi bazën e rrethanave të tilla gjykata konform nenit 75 par.1 nënpar 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së bëri zbutjen e dënimit dhe të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1/një/viti** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në çoftë se i pandehuri në periudhën kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, me bindjen se në rastin konkret edhe përmes shpalljes së dënimit dhe pa ekzekutimin e tij do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimeve, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale si dhe dënim **me gjobë** në lartësi prej **600/gjashtëqind/euro**, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nenit 83 par.1 të KPRK-së në dënimin e shqiptuar me gjobë të pandehurit i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 28 prill 2016 deri në datën 29 maj 2016,

Konform nenit 273 par.5 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuan me peshë 2.3 gram.

Konformë nenit 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 ( tridhjet ) euro, e cila është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të pandehurit dhe komplikushmerinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA,  
PKR.nr.142/16 e dt. 25.10.2016**

Sekretaja Juridike  
Adelina Sallahu

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Sahit Krasniqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.